



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA E APELIT TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM

**RISHPALLJE PËR LËVIZJE PARALELE
DHE PËR PRANIMIN NË SHËRBIMIN CIVIL TË PROKURORISË
PËR POZICIONIN SEKRETARE PRANË PROKURORËVE**

Për rifillimin e procedurës së konkurimit për pranimin në pozicionin e punës Sekretare pranë Prokurorëve, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Bazuar në nenin 42 gërma “a”, 76, 77 e vijues , të Ligjit Nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, Urdhërin e Prokurorit të Përgjithshëm, nr.54, datë, 18.04.2023 “Për strukturën organike të Prokurorive të Shkallës Parë, dhe Prokurorisë së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm”, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 495, datë 21.7.2022 “Për riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave dhe pozicioneve vakante të krijuara, si dhe bazuar nënenet 22 dhe 25 të Ligjit 152/2013 ”Për nëpunësin civil”.

Pozicionet më sipër, u ofrohen fillimisht nëpunësve civilë të prokurorisë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele!

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- Të jetë nëpunës brenda së njëjtës kategori;
- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”;
- Të plotësojë kriteret e veçanta të përcaktuara në shpalljen për konkurrim

Procedura e lëvizjes paralele përfshin dy faza:

- a) verifikimin e kandidatëve, të cilët përmbushin kushtet e lëvizjes paralele dhe kërkesat e veçanta të përcaktuara në shpalljen për konkurrim;
- b) vlerësimin e kandidatëve, ku përfshihen vlerësimi i përvojës në punë, trajnimet, kualifikimet e lidhura me fushën përkatëse, si dhe vlerësimet pozitive dhe **intervista e strukturuar me gojë**.

Vetëm në rast se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ky pozicion është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimi në shërbimin civil.



Konkurrimi për vendin e punës, Sekretare pranë Prokurorëve, do të bazohet në:

1. Ligjin nr.97/2016, “Per organizimin e funksionimin e Prokurorisë së Përgjithshme;
2. Ligji nr.96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve. në Republikën e Shqipërisë”
3. Ligjin nr.152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar,
4. Kodi i Procedurës Penale.
5. Ligjin nr.7961 datë.12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar.

Kërkesat e përgjithshme për kandidatët

- Të jetë shtetas shqiptar.
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.
- Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur.
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse.
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje.

Kërkesat e vecanta për kandidatët sipas nenit 76 pika 2.

- a) të jenë diplomuar në drejtësi;
- b) të kenë përvojë prej të paktën një viti të njohur si praktikë profesionale ose çdo lloj përvoje tjetër profesionale që lidhet me prokurorinë.

si dhe

- të mos ketë masë disiplinore në fuqi (të vërtetuar me një dokument nga institucioni).
- të ketë njohuri të mira gjuhësore e drejtshkrimi,
- të prezantojë etikë, qytetari dhe nivel performance të denjë për institucionet shtetërore dhe të pranojë e realizojë testimin bazë që përfshin komunikim të lirë me komisionin.

Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit

Të gjithë kandidatët si më sipër duhet të dorëzojnë pranë sekretarisë së Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, dokumentacionin si më poshtë:

- a. Jetëshkrimin;
- b. Kërkesë për aplikim
- c. Fotokopje të diplomës;
- d. Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- e. Çdo dokumentacion që vërteton eksperiencën të tjera punësimi brenda ose jashtë vendit, të lëshuar nga punëdhënësi;
- f. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;
- g. Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- h. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- i. Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;

Data e dorëzimit të dokumentave: 10.11.2024

****Afati i aplikimit dhe dorëzimit të dokumentacionit është i njëjtë për të dyja procedurat.***

Konkurrimi do të zhvillohet në dy faza:

I. Faza e parë:

- Verifikimi paraprak i kandidatëve për plotësimin e kërkesave të përgjithshme dhe atyre të veçanta të përcaktuara në shpalljen për konkurim
- Kryesekretaria në bazë të dokumentacionit të paraqitur, jo më vonë se 5 (pesë) ditë pune nga data e mbylljes së pranimit të tyre, do të bëjë verifikimin paraprak të kandidatëve, që përmbushin kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta, të përcaktuara në shpalljen për konkurim
- Kandidatet që plotësojnë kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta të pozicionit të punës, renditen në një listë sipas rendit alfabetik e cila administrohet dhe do të shpallet në faqen zyrtare të internetit Prokuroria e Përgjithshme dhe në hyrjen kryesore të Prokurorisë së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.
- Kandidatet, që nuk plotësojnë kërkesat e përcaktuara në shpalljen për konkurim, renditen në një listë të veçantë në të cilën regjistrohen edhe arsyet e mosplotësimit të këtyre kërkesave. Kjo listë nuk publikohet dhe administrohet në kryesekretari e cila njofton në mënyrë individuale kandidatët që nuk janë kualifikuar.
- Çdo kandidat ka të drejtë të paraqesë ankesë pranë kryesekretarisë brenda 5 (pesë) ditëve kalendrike nga data e shpalljes së listës. Ankuesi merr përgjigje brenda 5 (pesë) ditëve kalendrike nga data e depozitimit të ankesës .

II. Faza e dytë përbëhet nga vlerësimi i kandidatëve që përfshin:

- Vlerësimin e jetëshkrimit të kandidatëve, që konsiston në vlerësimin e arsimit, të eksperiencës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, si dhe vlerësimet e arritjeve vjetore;
- Vlerësimi me shkrim;
- Intervista e strukturuar me gojë;

Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët do të bëhet nëpërmjet adresave të email-it, me mesazhe në numrin e celularit të kandidatit, në faqen e internetit të Prokurorisë së Përgjithshme dhe ambjenteve të Prokurorisë së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Për çdo informacion më të hollësishëm gjithë të interesuarit të paraqiten në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

PROKURORIA E APELIT JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM

Tiranë datë 29.10.2024